

# **PASURIMI I GJUHËS SHQIPE NË VEPRAT LETRARE (GJUHA E VEPRËS SË VILHELME VRANARIT TEK ROMANET “UNIKALE” DHE “DHEMBJE NËNE”)**

**Alta HALUCI<sup>1</sup>**

<sup>1</sup> *Department of Language and Literature, Faculty of Human Sciences and Law, University of Vlorë “Ismail Qemali”*

---

## **Përmbledhje**

Punimi ynë ka të bëjë me prozën e shkrimtares Vilhelme Vranari. Ajo luan me fjalën e sidomos me të folmen e Vlorës dhe po aq këndshëm ndikon edhe në shijet e lexuesit duke e bërë atë të përfshihet dhe të bëhet një me atë që lexon. Në studimin e bërë në dy romanet e shkrimtares vëmendja më e madhe e studimit është përqendruar te ndarja e leksikut sipas pjesëve të ligjëratës, veçanërisht te mënyra e fjalëformimit të tyre. Ndër mjetet me vlerë emocionuese e stilistike në veprën e Vilhelme Vranarit zë një vend kryesor edhe frazeologjia.

Ajo që bie në sy është se në të dy romanet e studiuara një pjesë e madhe e emërtimeve të huaja janë shkruar ashtu siç janë në origjinal dhe nuk janë shqipëruar. Kjo, edhe për shkak të jetesës së shkrimtares jashtë kufijve të Shqipërisë, ndaj ajo e ka pasur më të lehtë për të dhënë një pasqyrë të vendeve, por edhe të kulturës së tyre. Mund të themi se huazimet nga gjuhët e huaja, ndryshe nga fjalët e huaja të panevojshme e të parrënjosura në gjuhë, e kanë gjetur vendin e tyre në gjuhë shumë mirë tek krijimet e V. Vranarit. Në studim kemi paraqitur edhe analizat statistike të fjalëve të ndara sipas pjesëve të ligjëratës nëpërmjet programit të konkordancave duke filluar me Word List, konkordancat e fjalëve dhe statistikat.

---

## **Hyrje**

*“Gjuha është pasqyra më e qartë e një kombi dhe e kulturës së tij”*. Kështu është shprehur gjuhëtari i njohur shqiptar Eqrem Çabej. Nisur nga kjo, morëm shtysën e punimit të një teme të tillë për prozën e shkrimtares Vilhelme Vranari. Leksiku i gjuhës shqipe është i pasur me fjalë të shumta që vijnë nga gurra e vjetër, por edhe me fjalë të reja të krijuara që kanë hyrë në përdorim. Vilhelme Vranari luan me fjalën e sidomos me të folmen e Vlorës dhe po aq këndshëm ndikon edhe në shijet e lexuesit duke e bërë atë të përfshihet e të bëhet një me atë që lexon.

Në studimin e bërë në dy romanet e shkrimtares vëmendja më e madhe e studimit është përqendruar te ndarja e leksikut sipas pjesëve të ligjëratës, veçanërisht te mënyra e fjalëformimit të tyre. Emri, mbiemri, folja, ndajfolja, numërori, përemri, parafjala, pasthirrma, pjesëza janë të gjitha pjesë të ligjëratës të cilat krijojnë atë plotësinë e leksikut dhe tablonë e plotë për ta studiuar atë nga pikëpamja morfologjike e semantike. Ndër mjetet me vlerë emocionuese e stilistike në veprën e Vilhelme Vranarit zë edhe frazeologjia një vend kryesor. Njësitë frazeologjike, të trashëguara brez pas brezi, përbëjnë një lëndë themelore ndërtuese në gjuhën shqipe, që e plotësojnë dhe e zgjerojnë fjalorin e saj dhe i sjellin atij ngjyrimë kuptimorë, stilistikore dhe shprehëse emocionuese të veçanta.

Në punim studimi mbi njësinë frazeologjike zë një pjesë jo shumë të madhe dhe i referohet ndarjes sipas kategorive leksiko-gramatikore. Nga ana tjetër, në studim kemi paraqitur edhe analizat statistike të fjalëve të ndara sipas pjesëve të ligjëratës nëpërmjet programit të konkordancave duke filluar me Word List, konkordancat e fjalëve dhe statistikën. Në gjuhësinë shqiptare mund të themi janë bërë studime të pakta në fushën e teknologjisë gjuhësore e në lidhje me nxjerrjen e konkordancave të veprave të autorëve shqiptarë, me qëllim hartimin e fjalorëve për leksikun e tyre.

*“Konkordancat për nxjerrjen e fjalëve të veprës së një autori shqiptar për herë të parë të ne u përdorën në analizën statistike dhe stilistike të veprës së Lasgush Poradecit në sistemin e madh kompjuterik NCR Criterion 8550”.* Në këtë punim për konkordancat dhe leksikun në prozën e Vilhelme Vranarit është bërë klasifikimi i leksikut për të parë kontributin e saj për pasurimin e fjalorit të gjuhës së sotme shqipe. Ajo që vlen të theksojmë është se fillimisht është bërë një punë e madhe hulumtuese në romanet “Dhembje nëne” dhe “Unikale” për evidentimin e të gjitha fjalëve të veçanta dhe të strukturuar sipas çështjeve të interesuara për studim. Më pas kemi punuar me programin e konkordancave për të arritur në konkluzione për çështjet e studiuara. Dosjet me informacionet përkatëse kanë ndihmuar shumë në zhvillimin e punës për studimin tonë.

## **Metodologjia e punimit**

Për realizimin e këtij punimi janë përdorur disa metoda. *Së pari*, metoda më e përdorur ka qenë **metoda e hulumtimit dhe skedimit të informacionit**. Vazhdimisht kemi krijuar dosje të caktuara në kompjuter me informacion sipas çështjeve të caktuara. Të gjitha këto na kanë shërbyer për të siguruar material të bollshëm për të vazhduar më tej studimin për leksikun e veprës së V. Vranarit. Kemi përdorur gjithashtu dhe **metoda të tjera kompjuterike** si: *metoda kompjuterike e skedimit me 2007, PAET (Programi Analitik Elektronik i Tekstit)*.

Teknika e parë na ndihmoi për të përkufizuar secilën fjalë, numrin e fjalëve të përdorura dhe na ndihmoi që të mos përsërisim të njëjtën fjalë më shumë se një herë. Nga kjo analizë nxorëm sa fjalë janë të mëvetësishme dhe sa herë janë përdorur. Gjithashtu kemi nxjerrë informacion edhe nëpërmjet **metodës së statistikave** të programit Scp 4.09.

**Hapi i parë ka qenë hulumtimi i materialit gjuhësor. Hapi i dytë** pas vjeljes së materialit, ka qenë përdorimi **i përshkrimit, krahasimit dhe vlerësimit i tyre**, duke gërmuar deri në veçoritë më pak të dallueshme gjuhësore. **Hapi i tretë:** Kemi zbatuar **metodën semantike, metodën e zëvendësimit dhe atë statistike**.

**Rrafshi leksikor dhe gramatikor** janë dy nga shtyllat ku u mbështet punimi ynë, por për t'i parë sa më mirë këto rrafshe, kemi konsultuar edhe autorë të shquar shqiptarë e te huaj për të qartësuar sa më mirë veçoritë gjuhësore në fushën e morfologjisë, sintaksës, dialektologjisë, leksikologjisë, gjuhës standarde etj. Por vlen të përmendim se **metoda kryesore e përdorur është ajo analitike** e cila na ka ndihmuar të shtjellojmë të gjitha tiparet fjalëformuese të pjesëve të ligjëratës por edhe analizën leksiko-gramatikore për njësitë frazeologjike.

## **Synimet dhe objektivat e studimit**

**Objektivat:** Në studimin tonë kemi pasur për qëllim që të studiojmë veçoritë e përgjithshme të gjuhës në 2 prozat: “Unikale” dhe “Dhembje nëne”, që të evidentojmë neologjizmat, huazimet, fjalët e huaja, dialektizmat a fjalët arkaike apo shmangiet e normës, por edhe për të vlerësuar propozimet e autores.

Morfologjia me klasën e emrave, mbiemrave, foljeve dhe ndajfoljeve është një nga rrafshet më të ndjeshme gjuhësore të cilën autorja e ka trajtuar më shumë kujdes, përveç disa formave simbolike të toskërishtes, që nuk e zbehin fare bukurinë e gjuhës. Mënyrat dhe strukturat e fjalëformimit në leksikun e përdorur nga shkrimtarja dëshmojnë njohjen e gjerë e të mirë nga ana e saj të formave më të vjetra të fjalëformimit dhe kjo e bën edhe gjuhën shumë më shprehëse. Leksiku dhe frazeologjia e dy romaneve “Unikale” dhe “Dhembje nëne” janë të larmishme. Vilhelme Vranari jo vetëm e kërkon fjalën e duhur, por edhe “eksploron” në semantiken e saj duke pasqyruar antonime dhe sinonime jo vetëm në nivel fjale, por edhe në frazeologji.

**Synimet:** Në punimin tonë qëllimin kryesor e zë studimi i leksikut sipas kategorive leksiko- gramatikore dhe studimi i tyre sipas programit të konkordancave. Objektivi kryesor që kërkojmë të arrijmë me këtë studim është zbulimi i sa më shumë fjalëve, ndërtimeve të tyre nga ana fjalëformuese, por edhe shprehive frazeologjike për të parë ndikimin që ato kanë në pasqyrimin e gjuhës shqipe. Gjithashtu qëllimi ynë në këtë studim është edhe të shikojmë dhe të nxjerrim statistika se sa shpesh janë përdorur fjalë të tilla dhe çfarë ndikimi kanë ato në gjuhën shqipe.

Në gjuhën e saj të bie shumë në sy krijimi i fjalëve të reja. Fjalë të cilat më parë nuk i kemi dëgjuar, por pena e saj artistike i ka krijuar mjeshtërisht që të vrasin jo vetëm veshin e lexuesit, por edhe, pse jo, të shërbejnë në pasurimin e leksikut të gjuhës sonë. Ajo luan me fjalën, e sjell dhe trajton atë në forma nga më të ndryshmet.

Studimi i prozës së V. Vranarit e përkatësisht në romanet “Unikale” dhe “Dhembje nëne” është përqendruar në verifikimin e pjesëve të ligjëratës dhe studimit të tyre sipas strukturës dhe fjalëformimit duke theksuar këtu disa parashtesa ose prapashtesa tipike të krijimtarisë së saj. Po ashtu, kemi dashur të sjellim e të përmendim edhe njësitë frazeologjike të përdorura në veprë për të treguar ndikimin e tyre në pasurimin jo vetëm të leksikut, por veçanërisht stilit të autores. Dhe në fund qëllimi ynë ka qenë që të bëjmë edhe një pasqyrim sipas programit Scp 4.0 të shpeshësisë të përdorimit të fjalëve të veçanta, të konkordancave të tyre, por edhe të dhënave statistikore.

## Ndikimi i gjuhës së vendlindjes

Fragment i shkurtër nga romani “Dhembje nëne” :

*Moti i ftohtë e i lagët i atij fund janari, ma shtonte akoma më tepër mërzinë e më bënte të ndihesha e kapitull e me dhembje koke. Prisja me padurim që të mbaronte ky udhëtim i tejloshshëm. Doja të mbërrija sa më parë në shtëpi, që të bëja një banjë e të çlodhesha, pas një jave të mundimshme larg familjes. E struktur në mbulesën e ftohtë metalike të autobuzit, mbështjellë me një shall të trashë, pa vetëdije, ndiqja me sy piklat e imta të shiut që binin mbi xhama pa zhurmë, që s'ishite gjë tjetër veçse borë e shkrirë. Papritur më tërhoqi vëmendjen një buqetë me lule të freskëta, me trëndafilë e me zambakë.*

Fragment i shkurtër nga romani “Unikale”:

*Jam e mendimit se gjithçka shndërrohet në mundësi për ata që janë pa skrupuj, pa norma e sidomos për ata që nuk njohin ligje dhe rregulla. Zakonisht të tillë janë të lëbyrtët, që s' shohin tej hundës së tyre dhe që e shohin botën bardhë e zi. Me këto mendime, pasi u hodha një sy fëmijëve, u drejtova për në dhomën e gjumit. U shtriva në shtrat tejet e rraskapitur. Ditët e fundit për mua kishin qenë tepër të ngarkuara, apo mos vallë unë vet e kisha tepruar duke dalë mbi veten, mbi aftësitë e mia fizike dhe mendore?*

E folmja e Labërisë paraqitet me disa ndryshime, që nuk mund të kalojnë pa rënë në sy edhe në veprën e Vilhelme Vranarit. Jemi gjendur përpara një dukurie interesante: Vilhelme Vranari, një labe, një përdoruese e mirë e toskërishtes, por edhe njohëse e mirë e standardit. Nga e ka origjinën shkrimtarja, një pjesë e madhe e zonës së Kaninës që banohet prej banorëve të kësaj treve, ashtu si gjithë Labëria, paraqet një natyrë konservative ndaj shqipes së të parëve.

Dallimet fonetike janë thelbësore në përcaktimin e tipareve dhe veçorive dalluese mes dialekteve dhe të folmeve. Në veprën e Vilhelme Vranarit janë pasqyruar shumë pak raste të përdorimit të të folmes së Labërisë: Zanorja *ë* është përdorur sipas dialektit toskë në vetëm pak raste si: *gjëmbi, qirasitë, sinitë, Hardhitë etj.* Sistemi i bashkëtingëlloreve *mb, nd, ng* janë përdorur si në shqipen standarde. Po ashtu shkrimtarja përdor togun zanor *ua*. Tërheqin vëmendjen fjalët e formuara më anë të parashtesës *tej-*. Po ashtu shkrimtarja përdor dendur foljen *jam* në kohën e pakryer në formë të shkurtuar si: *Stela ish krenaria e klasës, ish mburrja e shoqërisë sonë. Veç intelektit të falur, ajo studionte, lexonte dhe si rrjedhojë, për moshën që kish...* (f. 26); *...shkaktar ish ai me të vëllezërit dhe askush tjetër, etj.*

Leksiku i vendlindjes është e pamundur të mos ndikonte në romanet e Vilhelme Vranarit. Shumë shpesh i drejtohet leksikut të vjetër për të karakterizuar sa më mirë situatën dhe personazhet si: *pjella, Kangjella, sevdalli, strumbullar, këndezi, doke, zakone, dynja, kooperativë, dergjem, etj.* Në romane një ndikim tjetër i së folurës popullore duket edhe në emrat e kafshëve sipas ngjyrës, madhësisë, sjelljes si: *bardhoshja, kllçoça, zeza, etj.*

Frazeologjia e romaneve nuk mbështetet vetëm në frazeologjinë e vendlindjes, por në frazeologjinë e popullit shqiptar në përgjithësi, nga jugu në veri. Megjithatë, duhet theksuar se Vilhelme Vranari frazeologjinë krahinore e përdor shumë më dendur e kryesisht në romanin “Dhembje nëne”. Kemi konstatuar se sidomos në momentet kulmore të dëshpërimit, përdor frazeologjinë karakteristike të Labërisë si: *Vdekja s’ka radhë, Nuk mban më ujë pilaf, Na ka ardhur shpirti në majë të hundës, Do ziente fshati, nuk dua të m’i shpojë as gjëmbi, Ndau shapin nga sheqeri, I dha drejtim, Të shkoni për dhjamë qeni etj.* Shkrimtarja përdor edhe mjaft fjalë të urta si: *Dardha e ka bishtin pas, E di i zoti ku i pikon shtëpia, Gjuhë, e cila tule është, por kocka thyen, Bëni si them unë dhe mos bëni si bëj unë, Atë që të bën fëmija s’ta bën as Perëndia etj.*

Vlerat etnokulturore zënë një vend të rëndësishëm në romanin “Dhembje nëne”, ndonëse në zanafillë dhe në qëllim kjo vepër është shumë larg me etnografinë, por në momentet më të vështira, behën të pranishme zakonet, traditat dhe mendësia e shqiptarit në përgjithësi, sepse shkrimtarja njih gjithë Shqipërinë, por nëna labe, e mbyllur mes dhembjes dhe kalasë së Kaninës, është më e preferuara për shkrimtaren. Në të dyja romanet gjejmë të pasqyruara një mori dokesh e zakonesh të vjetra. Shumë prej tyre kanë shkuar drejt harresës, por që e gjykojmë së përbëjnë mjaft interes për kulturën dhe gjuhësinë tonë. *Se si qan zemra e një nëne, tregohet në roman, si jeton dhe kur brenda ka vdekur po në atë moment ku pjella e saj ndalon së marri frymë.* Në Labëri njerëzit thirren me mbiemrin e fisit ose si mbiemër-emri i babës. Në vepër vëmë re edhe shprehje të cilat marrin kuptim në kontekstin dhe situatën ku janë përdorur.

Ja shembujt:

*“Çdo berr varet nga këmbët e veta djalo ndaj... Përsëri më lind një dyshim, ç’të detyron ty, bir agai, të bashkëpunosh me të huajin? Daja im për të mbrojtur pronën interesat e veta, i përkrahu italianët. Përfitoi mjaft prej tyre”.*

*“Ju vratë ata djem trima vetëm se u shprehën kundër vëllavrasjes, megjithëse ishin në çetat partizane. E di çdo të thotë të vrasësh tjetrin pas shpine, pa e ditur arsyen dhe pa gjyq. Unë e quaj krim makabër, madje tradhti. Kush ndot në derë të xhamisë e dënon Zoti”.*

*“Ti qysh tani je në ditë të hallit. Po nesër? Mos harro, lufta shkatërron gjithçka, sidomos ekonominë, duke të lënë me gisht në gojë”.* *“Roje takimi im mbaroi!, - thirra policin, dhe i lashë të mitë me gisht në gojë, tejet të çuditur me vendosmërinë time”.*

## Vështrim i përgjithshëm i leksikut te dy romanet

Vilhelme Vranari është një autore e cila për të përcjellë sa më mirë situatën e rëndë të kohës, mjedisin ku veprojnë personazhet, kthimin në një kohë të kaluar, ndjenjat dhe ngarkesën emocionale, bën të mundur krijimin e fjalëve të reja, përfshirjen e dialektizmave, risjelljen e arkaizmave dhe paraqet ndikimin nga vendet e huaja mbi leksikun e shqipes. Romanet e saj karakterizohen nga formime të fjalëve të reja apo formime situacionale. Një nga burimet shprehëse në romanet e saj është krijimi i fjalëve dhe kuptimeve të reja, dukuri e cila haset shpesh në faqet e romaneve. Disa prej tyre janë:

### *Neologjizmat e romanit “Unikale” dhe “Dhembje nëne”*

Ashtu si e përmendëm më sipër, për të përcjellë gjendjen e ngarkuar emocionale dhe psikologjike të personazheve të saj, autorja detyrohet të gjejë një mënyrë të re shprehjeje. Këtë e mundëson falë krijimit të neologjizmave të cilat formohen nga autorja përmes kompozitave. Më poshtë kemi paraqitur disa shembuj: *Këtu në qelinë e ftohtë në netëvdekjet e vetmisë së pafundme shoh kurmin tënd vetëm duke pasur parasysht hijeshinë, brishtësinë e tij, finesën tënde në ecje dhe gjithçka që të përket ty e dashur;* • *Për fat të keq çka ëndërroja për ty u shndërrua në një motstuhi i cili la pas pluhur e hi, duke shkatërruar ëndrrat e bukura vajzërore, t’ i vrau shpresat për një jetë të bukur dhe të mohoi ndjenjat.*; • *Po sikur të dënohem me jetëburg siç thotë hetuesi.*; • *Bashkë me dhimbjen e jetëburgut do të gëlltit edhe helmin e ndarjes nga ajo që doja më shumë në këtë botë të rreme.*; • *Nga çdo qelivarr dukej se rilindte jeta.*; • *Kjo ngjarje e hidhur na trishtoi dhe një heshtje rrëqethëse shoqëronte ditët e zymta të qelivarreve.* • *Më dukej sikur kisha qëndruar për javë në vigvdekje.*; • *Nuk mund ta harroj kurrë një të moshuar që dergjej në vigvdekje.*; • *Nuk na lidhte gjaku por dhembjet vuajtjet nga më çnjerëzoret dhe fati. Ne ishim të barabartë në halle dhe ndoshta edhe në fundjetëetj..*

Pra, neologjizmat janë të shumtë, pa i ndarë sipas klasave leksiko-gramatikore si: *angështim, amarrok, jetëburg, fundjetë, qelivarre, motstuhi, netëvdekje, vigvdekje, agimor, baltovinë* etj. Neologjizmat kryesisht janë të formuar ose me prapashtesim, ose me kompozim. Ata janë ndërtuar me lëndën e gjuhës amtare sipas këtyre gjedheve fjalëformuese tashmë të njohura. Në një fjalë të re kemi njësim të së vjetrës me të renë: të vjetrat janë mjete të cilat e përbëjnë atë, kurse e re është vetë fjala, kuptimi i saj dhe kjo i jep veprës veçantinë artistike.

### *Arkaizmat dhe fjalët e huazuara*

Vihet re në romane rritja e kujdesit të autores për gjuhën si mjeti bazë i formës, i kumtimit të përmbytjes së veprës, të ideve dhe mendimeve. Në prozë gjuha e pasur, e punuar nga shkrimtarja kryen dy funksione të rëndësishme: *së pari*, i jep ngjyrim artistiko-letrar veprës dhe, *së dyti*, shërben për të individualizuar personazhet si mëshirues të karaktereve shoqërore, që i përkasin një periudhe të caktuar. Të bie në sy rritja e interesimit të autores për të zgjedhur fjalët dialektore apo krahinore për të na sjellë personazhet e kohës që ajo sjell në prozën e saj. *Fjalët e vjetruara, historizmat dhe arkaizmat*, kur përdoren në vepër, ajo i përdor për të tipizuar personazhet, për të karakterizuar mjediset shoqërore apo për të na shfaqur zakonet e traditat e fshatrave në jug të Shqipërisë dhe për të dalluar më mirë kohën kur kanë ndodhur ngjarjet që përshkruhen në vepër. Ndaj autorja i përdor aq sa i shërbejnë qëllimit të saj, duke u nisur nga tema e fjalëve të vjetruara.

Hasim fjalë të tilla, të cilat lidhen me sferën e zakoneve, me jetën dhe dhimbjen si: • *Xanxar (i pashtruar), huqe (ves), vickla (kundërshtime), derëbardhi (i gëzuar), kërbaç (shkop për të rrahur), sinorin (kufi), derte (brenjë), qosteku (zinxhirë për orën e xhepit), vegjë (vegël për endjen e qilimave), lipset (largohet), sodisje (vështrim), soj (fis), kabull (pranim), ungji (xhaxhai), breronte (bie pa ndërprerë), inxhi (diamant), zwordhte (ngordhte), mëncuri (jo mëncuri), dalldisur (i turbullt), karfosur (qep), gjysha (jo gjyshja), e kaurdisur (përziej), mandatën (lajm i keq), u shpraza (u zbrasa), takëm (tërësia e sendeve),*

*pehlivan (dredharak), gjym (enë e metaltë si qyp), fshesa prej melakuqeje, basamakë (shkallare), u suall (u soll), hudutin (zapotj), u muar (u morr), llagëm (kanal), pa plangë e pa prokopi (pa plaçkë e pa pasuri), u breshtua (ngriu), gjëmë, sevdalli, kangjella etj.*

Autorja nuk ngurron të përdorë edhe fjalë të ligjërimit bisedor që shërbejnë për karakterizimin e stileve gjuhësore. Ato janë huazime nga turqishtja, greqishtja apo sllavishtja si: *Saraj, oxhak, kuti, boja, cohë, zanat, kasap, hesap, amanet, xhelat, bori, vasalë, zotnillëk, mëhalla, kapadillëk, kaza, nizamë, vatanit, kasabasë, merhum, dynjanë, bej, aga, pasha, myfti, kadi, mytesarif, sodisje, kabull, minderin, inxji, bahçes, musëndrat, zallamahi, sokak, pishmanllëk, gazep, dobi etj.*

Këto huazime, sidomos huazimet nga gjuha turke, janë përdorur nga autorja për të dhënë në mënyrë më të qartë mjedisin qytetar, popullor dhe akoma më shumë afrinë e gjuhës së veprës me ligjërimin e zakonshëm. Më poshtë kemi disa fjalë, të cilat shumë mirë mund të ishin shmangur sepse ato kanë gje gjegjëset e tyre në shqip:

- *Akoma- ende* (gr.)

- *Aktivitet- veprimtari* (ang.)

*Ambient- mjedis* (it.)/*Bosh- i zbrazët* (turq.)/*Bollëk- shumicë* (turq.)/*Bulevard - shëtitore* (ang.)/*Dakord- ishin në një mendje* (fr.)/*Direkt- i drejtpërdrejtë* (ang.)/*Maske falsiteti- të rreme* (lat.)/*Të firmosësh- të nënshkruash* (it.)/*Të kompletosh veten- ta plotësosh* (lat.)/*Kompshi - komshi- fqinji* (turq.)/*Për kuriozitet- për kureshtje* (ang.)/*Legjitim- i ligjshëm* (it.) etj.

## **Mbi përkufizimin dhe klasifikimin e njësive frazeologjike**

Terminologjia që është përdorur nga gjuhëtarë të ndryshëm për përkufizimin e njësisë frazeologjike është shumë e larmishme. Po të shikojmë, shumica e përkufizimeve të dhëna janë në koherencë me njëri-tjetrin konceptualisht, por larmishmëria e madhe e tyre ka shkaktuar jo pak herë edhe pështjellime. Ndryshimet në terminologji reflektojnë ndryshime të caktuara në lidhje me kriteret kryesore që përdoren për të bërë dallimin ndërmjet togfjalëshave të lirë dhe këtij tipi të veçantë të njësive gjuhësore të quajtura njësi frazeologjike. Mund të përmendim disa nga përkufizimet e dhëna:<sup>1</sup> “*njësi frazeologjike, idiomë apo togfjalësh i qëndrueshëm. Në punime të ndryshme shkencore vërehet gjithashtu përdorimi i termave si: lokucion, shprehje idiomatike, frazë, frazomë, frazë e qëndrueshme, kombinim fjalësh, frazeologjizëm etj.*”

Përkufizimi më i pranueshëm që është bërë në lidhje me njësinë frazeologjike është:<sup>2</sup> “*Njësi frazeologjike është njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm e përbërë nga dy a më shumë fjalë shënuese me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm e formuar historikisht, që ka vlerën e një fjale të vetme, riprodhohet në ligjërim e gatshme dhe funksionon në gjuhë si njësi e pandashme*”.

Një përkufizim të tillë e gjejmë si te “*Leksikologjia e gjuhës shqipe*” (2012) e Jani Thomait, por edhe te “*Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*” (1999).<sup>3</sup> “*Në fushën e shqipes si tipare të përgjithshme të njësisë frazeologjike janë njohur, struktura togfjalëshore, njësi kuptimore, qëndrueshmëria, figurshmëria, neutralizimi i raporteve të brendshme sintaksore, njëvlerësia me fjalën nga ana e kuptimit kategorial dhe e funksionit në ligjërim*”. Pra, në mënyrë të përmbledhur janë përcaktuar kriteret që duhen për të pasur njësi frazeologjike. Njësitë frazeologjike janë një pjesë e rëndësishme e gjuhës që bëjnë të mundur bashkëveprimin shoqëror, rritin koherencën e tekstit, si dhe reflektojnë modelet kryesore të mendimit njerëzor. Ato nuk janë thjesht togje fjalësh të qëndrueshme.

<sup>1</sup> Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Toena, Tiranë, 2006, f. 235.

<sup>2</sup> Jani Thomai, *Çështje të frazeologjisë të gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1981, f. 269.

<sup>3</sup> Nexhip Mërkuri, *Formimi gjuhësor, njësi frazeologjike*, Triptik, 2014, f.122.

Përcaktimi i konceptit të frazeologjisë gjuhësore në lëmin e fushës së frazeologjisë në gjuhën shqipe ka qenë gjithmonë një çështje e diskutuar nga studiuesit:<sup>4</sup> “Për t’i përdorur drejt njësitë frazeologjike është e domosdoshme të njihen mirë të gjitha anët e tyre: përmbajtja, forma, kategoria leksiko-gramatikore, vlera stilistiko-emocionuese, burimi, lidhjet sintagmatike etj.” “Të tria aspektet, - forma, kuptimi e përdorimi, - kushtëzohen nga natyra e njësisë frazeologjike, prandaj ajo mund të veçohet duke njohur këtë natyrë specifike të saj”.

Një problem tjetër që haset në çështjen e përkufizimit të njësive frazeologjike është ndonjëherë edhe ngatërresa që i bëjnë me togfjalëshin e lirë, duke qenë se nga pikëpamja strukturore janë të ngjashëm nga njëri-tjetri. Por njësia frazeologjike dhe togfjalëshi janë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Njësitë frazeologjike fillimisht e kanë nisur jetën e tyre si togfjalësha të lirë dhe me kalimin e kohës kanë kaluar në togfjalësha të qëndrueshëm, kur janë përdorur me një kuptim metaforik. Prandaj deri diku është e vështirë të vendosësh një kufi të palëvizshëm midis tyre, por ka disa elemente që i dallojnë ato nga njëri tjetri, si:

- Njësitë frazeologjike nuk mund të krijohen në momentin e të folurit, por hyjnë në ligjërim si njësi të gatshme, ndërsa togfjalëshi krijohet në momentin e ligjërimin.

- Togfjalëshi i lirë mund të zërthehet në gjymtyrë të cilat krijojnë lidhje me fjalë të tjera, ndërsa njësia frazeologjike jo.

- Rendi i fjalëve në njësitë frazeologjike është i ngulitur, pra janë të qëndrueshme si nga pjesët përbërëse dhe nga ndërtimi, ndërsa togfjalëshi i lirë nuk e ka rendin e fjalëve të ngulitur.

- Njësitë frazeologjike kanë ngjyrime emocionuese, të cilat shprehen nëpërmjet figurativitetit, ndërsa togfjalëshi i lirë jo.

Kjo, për të kuptuar që vërtet strukturalisht dhe nga prejardhja ata kanë lidhje me njëri-tjetrin, por nuk janë e njëjta gjë dhe përkufizimi i njësisë frazeologjike nuk mund të ngatërrohet me togfjalëshin. Klasifikimi i njësive frazeologjike bëhet duke u mbështetur në disa kritere të ndryshme, si në formën, kuptimin, funksionin etj. Bazuar nga kjo njësitë frazeologjike i klasifikojmë:

1. Sipas ndërtimit (njësi frazeologjike me strukturë togfjalëshi dhe njësi frazeologjike me strukturë fjalie).

2. Nga vlera leksiko-gramatikore (njësi frazeologjike emërore, mbiemërore, foljore dhe ndajfoljore).

Në romanet e studiuara në punim kemi shqyrtuar në mënyrë të hollësishme klasifikimin e njësive frazeologjike sipas vlerës leksiko-gramatikore.

## **Struktura e frazeologjizmave të gjuhës shqipe**

Mes tipareve dalluese të frazeologjizmave të gjuhës, njësimi kuptimor i fjalëve përbërëse dhe funksioni gramatikor i frazeologjizmit në tërësi përbëjnë dy më të rëndësishmit. Por, si e vërejmë në shembujt e sjellë më sipër, kur frazeologjizmat hyjnë në fjali të ndryshme, jo vetëm nuk e ruajnë skemën, rendin e fjalëve të modelit të tyre fillestar, por edhe shpërbëhen, meqenëse shpërbëhen lidhja, njësimi kuptimor dhe gramatikor i frazeologjizmit: gjymtyrët e tij mund të kryejnë funksione të ndryshme brenda në fjali ose në fjali të ndryshme.

Pra, në gjuhën shqipe gjatë prishjes së rendit të fjalëve të modelit fillestar të frazeologjizmit, gjatë ndërftjes së fjalëve të tjera në mes komponentëve të tij dhe gjatë shpërndarjes së gjymtyrëve të tij në fjali të ndryshme a ndryshon funksioni sintaksor i frazeologjizmit, a prishet njësimi kuptimor i frazeologjizmit? Në qoftë se po, atëherë në ç’drejtim dhe deri në ç’skallë?

---

<sup>4</sup> Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe, Tiranë, 1999.

Natyrisht që lind edhe një pyetje tjetër e rëndësishme: Cili nga këto dy tipare (njësimi kuptimor apo funksioni gramatikor) është më i rëndësishmi për frazeologjizmat e gjuhës? Siç thotë J.Thomai: *“Duhet mbajtur parasysh se kur flasim për “rend fillestar të fjalëve”, nuk e absolutizojmë atë, e përdorim në mënyrë konvencionale, sepse për shqipen e sotme i ashtuquajtura rend fillestar i fjalëve, që përqaset me rendin logjik të gjymtyrëve, nuk është tipar absolut”*.

Dhe vazhdon: *“Zakonisht në shqipe shumë frazeologjizma ka mundësi të hyjnë në fjali si një gjymtyrë e vetme, si kryefjalë, kallëzues, rrethanor etj.”*. Por, sikurse është mundësia e prishjes së rendit të fjalëve të modelit fillestar, ashtu është mundësia edhe e shpërndarjes së gjymtyrëve të frazeologjizmit. Shpërndarja e komponentëve ndodh jo vetëm brenda një fjalie, por edhe në fjali të ndryshme. Në rastin e parë shpërndarja e komponentëve bëhet për shkak të futjes në mes të tyre të fjalëve të tjera plotësuese që lidhen herë me njërin, herë me tjetrin komponent. Kategoria leksiko-gramatikore e fjalës që ndërfitet në mes të komponentëve të frazeologjizmit, përcaktohet nga komponenti prej të cilit varet formalisht; në një frazeologjizëm foljor *folje + emër* mund të ndërfitet si ndajfolje (a pjesëz) e lidhur me foljen, ashtu dhe mbiemëri lidhur me emrin etj.

### Njësitë frazeologjike ndajfoljore

*“Kanë kuptimin e përgjithshëm të kategorisë së ndajfoljes, d.m.th. kanë vlerë ndajfoljore dhe funksionojnë në gjuhë si ndajfolje”*. Në njësitë frazeologjike ndajfoljore përfshihen këto grupime:

- Njësitë frazeologjike që krijohen nga përsëritja e së njëjtës fjalë ose nga dy fjalë që kanë njëfarë lidhje me njëra tjetrën, si : i foli anës e anës, larg e larg, derë më derë, degë më degë, sot për sot, hap pas hapi, vend e pa vend, kodra mbas bregut, gjerë e gjatë, kryq e tërthorë, poshtë e lartë, shkel e shko etj.

- Njësitë frazeologjike që nisin me lidhëzat krahasuese si dhe sa, psh. : <sup>63</sup>*si dritën e syrit, si sëpata pa bisht, si qeni në vreshtë, si kau balash, si cjapi te kasapi, si peshku pa ujë, sa për sy e faqe, sa gishtat e dorës, sa gjatë gjerë, sa frëngu pulën etj.*

- Njësitë frazeologjike që nisin me parafjalën me, për, në, nga, psh : me mish e me shpirt, me gisht në gojë, me presh në duar, me zemër të hapur, për mustaqet e çelos, për pesë pare spec, për ujë të ftohtë, nga sytë këmbët, për dhjamë qeni etj.

- Njësitë frazeologjike me strukturë fjalie , psh : sa çel e mbyll sytë, sa të hanë qentë, sa të thotë goja, sa të thuash pesë, ku ha pula gurë, me sa kishte në kokë etj.

Për njësitë frazeologjike ndajfoljore kemi edhe një përkufizim tjetër në FFSHGJ në të cilin ato përkufizohen si të tilla nisur nga ajo që e quajnë “çerdhja frazeologjike” që krijohen sipas sistemit fjalëformues si pasojë e kreativitetit.

*“Njësi frazeologjike ndajfoljore, që vijnë nga tipi foljor, me gjymtyrë të parë një pjesore të prirë nga një parafjalë (pa lënë gjurmë nga lë gjurmë)”*. Në romanin “Unikale” dhe “Dhembje nëne” kemi evidentuar disa njësi frazeologjike ndajfoljore. Shembujt e marrë nga romanet janë si më poshtë :

***E njohin njëri- tjetrin me rrënjë e me dhëmballë.- E njohin mirë.; Lumi që na mori. – E pësoi keq.; U zhduk si sëpata pa bisht.- Pa gjurmë.; Kokat tona janë në satër.- Janë në rrezik.; Koka bën, koka pëson, plaç moj zemër që rënkon.- Është vetë fajtor.; Fjalët i merr era.- Flet kot.; Duhet vënë gishti kokës.- Mendo mirë.; Si qeni në vreshtë.- Vritet kot.; Si kali në lëm. – Vjen vërdallë. Qeshi thellë.; Sa dhe muret u zgjuan (Si qau gjatë, sa dhe muret u zgjuan, fëmija përfiti...); Jam deri në grykë (...t’ia thoshte asaj në sy, jam deri në grykë me këtë maraz...); Sa qimet e kokës (...që do të kushtonin sa qimet e kokës për një lokalitet...); Nga sytë këmbët (...një pjesë e ture iknin nga sytë këmbët dhe binin pre e magjistraleve...);***



**Fill i brishtë** (*Vetëm ky fill i brishtë sigurie, e mbante ulur.*); **Si shi gërmash** (*Një si shi gërmash.*).

### Njësitë frazeologjike emërore

“*Kanë kuptimin e përgjithshëm të kategorisë së emrit, pra kanë vlerë emërore dhe funksionojnë në gjuhë si emra*”<sup>5</sup>. Në njësitë frazeologjike emërore, përfshihen njësi të ndryshme nga ndërtimi, të cilat janë:<sup>6</sup>

- Njësi frazeologjike të cilat janë të ndërtuara me gjymtyrë emërore, p.sh.: *qiqra në hell, ëndrra në diell, të zitë e ullirit, stan me lepuj, këmbëza e urës, kënga e Mukës, gozhde në zemër, thel mbi bisht etj.*

- Njësitë frazeologjike që ndërtohen nga disa terma të pathjeshtë të fushës së gjeografisë, historisë, bimësisë, të cilat zakonisht ndërtohen nga emra dhe mbiemra, p.sh.: *gjuhë lope, gjurmë mushke, bisht lepuri, mollë dheu, hith të vdekuri, nusja e lalës, lakuriqi i natës etj.*

Një tjetër përkufizim për njësitë frazeologjike emërore është edhe ai bërë në FSHGJH , i cili ka të bëjë me dukurinë e “çerdhes” frazeologjike që formohet sipas sistemit fjalëformues. Në dy romanet e studiuara dukuria e përdorimit të njësive frazeologjike me vlerë emërore nuk është shumë e zhvilluar, por vihet re përdorimi i saj në disa raste në romane ku autorja me shumë stil dhe finesë ka ditur t’i përshtatë dhe t’i sjellë mjaft bukur. Shembujt e studiuar vijnë si më poshtë:

**Thana në Shën Ndre.- Mosrealizim.; I ke buzët me qumësht.- Kalama.; Ta marrë i njëjti gjumë** (*Edhe për veten lutet ta marrë i njëjti gjumë, por me të...*); **Gjaku lyp gjak** (*...Fran ti e di gjaku lyp gjak...*); **Pikë zie** (*E kishte një pikë zie ajo ikje në thellësi.*); **E do radha** (*...se je plak dhe e do radha.*); **Gjëmbin e së keqes** (*...siç kishte fshehur gjëmbin e së keqes...*); **Nën erë gjaku** (*Njerëzit ishin ende nën erë gjaku...*); **Re e heshtur nënkuptuese** (*Një re e heshtur, nënkuptuese, varej mes miqësisë së tyre.*); **Shtjella e humbjes** (*...ku kishte vrapuar të gjente dalje nga shtjella e humbjes.*); **Mekja e mekanizmit shpirtëror** (*Ose, të mbetej nga mekja e mekanizmit shpirtëror në mes...*)

### Përfundime

Vilhelme Vranari shquhet për njohje të thellë të mundësive dhe aftësive të mëdha të shqipes për krijimin e njësive të reja. Ajo herë e nxjerr atë nga harresa duke e risjellë në jetë ashtu siç është ose duke i dhenë një ngjyrim të ri kuptimor a stilistikor, dhe herë nga dialektet për ta futur thellë në gjuhën e letërsisë artistike. Ajo i mëshon faktit që gjuha dhe stili janë një dhunti e shkrimtarit, por nga ana tjetër ai duhet të dijë t’i përdorë ato me zgjuars, që të jenë në koherencë me realitetin shoqëror dhe të mos humbasin në pluhurin e harresës.

Kemi studiuar leksikon e Vranarit sipas pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës ku përfshihen emri dhe mbiemri. Në dy romanet e Vilhelme Vranarit në rastin e emrit kemi bërë dhe një studim të shkurtër në lidhje me emrat e personazheve që ka përdorur autorja, emra gjeografikë, emra revistash, gazetash, emrat me shkurtesë.

- Në të gjitha këto mund të themi se ajo që të bie në sy është përdorimi i shumtë i emrave të huaj si tek emërtimet gjeografike që janë për vende të huaja p.sh.: *Holandë, Nju Jork, Los Anxheles, Amerikë, Ballkan, Kroaci, Las Vegas, Kalifornia, Toskana, Londër.* Disa emërtime shqiptare si: *Fushë-Krujë, Kosovë, Prishtinë etj.*

<sup>5</sup> Nexhip Mërkuri, *Formimi gjuhësor, njësia frazeologjike*, Triptik, 2014, f. 130.

<sup>6</sup> Po aty, f. 130.

- Emra personazhesh si: *Aleksi, Lura, Natali, Migel, Tereza, Mikelin* me prejardhje të huaj ose emra gazetash, revistash dhe rrugësh me emërtime të huaja si: *Mirazh, Nudo Blu De Rode Winkel, Broekman, Perry Sport, We, Browcer, Bozhuri, Museum of Contemporay, Art, Grand Avenue, Groyhound, Mojave Desert, Mc Carran, Sierra Nevadas, Barstow, Little Tokyo, Malev, Papillon, De Volksktantetj.*

Vihet re se në të dy romanet e studiuara një pjesë e madhe e emërtimevetë huaja janë shkruar ashtu siç janë në origjinal dhe nuk janë shqipëruar. Kjo, edhe për shkak të jetesës së shkrimtares jashtë kufijve të Shqipërisë, ndaj ajo e ka pasur më të lehtë për të dhënë një pasqyrë të vendeve, por edhe kulturës së tyre. Në fund të gjithë kësaj mund të themi se huazimet nga gjuhët e huaja, ndryshe nga fjalët e huaja të panevojshme e të parrënjosura në gjuhë, e kanë gjetur vendin e tyre në shumë mirë te krijimet e V. Vranarit.

Nga ana tjetër kemi studimin e emrave si pjesë e leksikut sipas tipave të fjalëformimit më të përdorura në të dy romanet.

- Aty kemi parë se përdoren formimet e emrave me parashtesën *nën-*. *Parashtesa nën- është me origjinë parafjalore. Ndërtimet me anë të kësaj ndajshese nuk janë shumë të gjalla në gjuhën e folur popullore, por kanë filluar të bëhen prodhuese në gjuhën e shkrimit sipas gjedheve së gjuhëve të huaja, si: nëndetëse, nëndrejtor etj. Shembujt në romane janë: nënbarkut, nënkresë, nënsyve, etj.*

- Formimet me prapashtesat zvogëluese *-th/-thin/-za/-zë*. Në tekstin e Morfologjisë kemi të shprehur mendimin se “prapashtesat *-th, -zë* kanë një denduri përdorimi në gjuhën letrare, sidomos në krijimet poetike”. Shembujt vijojnë si: *yllth, shishezën, gropthi, letërza, shenjëza etj.*

- Formimet me prapashtesat *-tar/-or/-ore* si: *gazetare, shkrimtare, harrestarët, etj.* Gjuhëtari E. Hysa, duke trajtuar këtë formim të emrave, nënvizon faktin se “ato tregojnë origjinën, duke shënuar banorin e një fshati, të një krahine a të një qyteti ose shënojnë mjeshtrinë e një personi, i cili merret me atë që tregon tema fjalëformuese”. Në raste të tilla si: *hekurar, katundar, mesjetar, shkollar, letrar, dijetar, shortar, gënjeshtar etj.* Te Vranari nuk e kemi vënë re një dukuri të tillë.

- Kemi dhe ndërtimet e përbëra të emrave të formuar nga bashkimi i dy temave në një të vetme si p.sh.: *funddimër, messhkurt, fillimverë, cepsytë, buzëmbërmeje, rrugështigjet, lulekafshim etj.* Në të gjitha këto shikojmë se emrat e përbërë janë një karakteristikë në krijimtarinë e Vranarit dhe zënë pjesën më të madhe të fjalëformimit të saj. Disa prej tyre janë edhe meritë e penës krijuese të shkrimtares si: *Murdritë, lulekafshim, messhkurt, cepsytë etj.* Ndërsa prapashtesimi është po ashtu një mënyrë tjetër fjalëformimi tek emrat në romanet e V. Vranarit që zë një vend kryesor ndërsa prapashtesimi i përket një grupi më të vogël krijues tek emrat.

- Në gjithë studimin e bërë për njësitë frazeologjike shohim se pjesën më të madhe të njësive frazeologjike e përbëjnë ato me vlerë foljore, më pas vijnë ato me vlerë mbiemërore dhe në fund ato me vlerë ndajfoljore dhe emërore. Studimi i njësive frazeologjike është shumë i rëndësishëm pasi, të trashëguara brez pas brezi, ato përbëjnë një lëndë themelore ndërtuese në gjuhën shqipe, që e plotësojnë dhe e zgjerojnë fjalorin e saj dhe i sjellin atij ngjyrime kuptimore, stilistikore dhe shprehëse emocionuese të veçanta. Njësitë frazeologjike të përdorura në prozën e Vranarit janë edhe kontribut i penës, imagjinatës dhe pasionit të fuqishëm të shkrimtares pasi në disa raste ato janë fryt i krijimtarisë së saj artistike.

## Referencat

- [1]. *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 1980, 1984, 2002.
- [2]. *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2004.
- [3]. *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1976.
- [4]. *Fjalor i antonimeve në gjuhën shqipe*, Shkup, 1998.
- [5]. *Fjalor enciklopedik letrar*, SHBLSH, Tiranë, 2001.
- [6]. *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Jani Thomai, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1999.
- [7]. *Fjalor i antonimeve në gjuhën shqipe*, Miço Samara, Akademia e Shkencave e RSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, “Shkupi”, Shkup, 1998.
- [8]. *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Jani Thomai, Miço Samara, Hajri Shehu, Thanas Feka, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2004.
- [9]. Shkurtaj, Gj., *Sociolinguistika*, Morava, 2009.
- [10]. Shkurtaj, Gj., *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë, 2002.
- [11]. Shkurtaj, Gj., *Tregues të etnografisë së të folurit në emrat e farefisnisë në gjuhën shqipe*.
- [12]. Çabej, E., *Studime etimologjike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1987.
- [13]. Çabej, E., *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1976.
- [14]. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Dialektologjia shqiptare III*, Tiranë, 1975.
- [15]. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973.
- [16]. Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002.
- [17]. Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Tiranë, 2002.
- [18]. Ajeti, L., *Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, 1978.
- [19]. Bello, Dh., *Onomastika dhe rëndësia e zhvillimit të saj*, Takimi IV Vjetor Ndërkombëtar, Instituti Alba-Shkenca, Tiranë-Prishtinë-Shkup, 2010.
- [20]. Lloshi, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 1999.
- [21]. Beci, B., *Rreth tipareve karakteristike të dy dialekteve të shqipes*, SF 4, Tiranë, 1978.
- [22]. Xhuvani A., Çabej, A., *Parashtesat e gjuhës shqipe (1956)*, në “Vepra I”, Tiranë, 1980.
- [23]. Memisha, V., *Studime për fjalën shqipe 3*, Tiranë, 2017.
- [24]. Demiraj, Sh., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986.
- [25]. Kostallari, A., *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”.
- [26]. Ashta, K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, I, Shkodër, 2000.
- [27]. Thomai, J., *Çështje të frazeologjisë të gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë 1981.
- [28]. *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë 1999.
- [29]. Thomai, J., *Një klasifikim i frazeologjizmave në gjuhën shqipe*, “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972.
- [30]. Thomai, J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë, 2006.
- [31]. Hysa, E., *Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004.